



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 25

Datë: 17. 04. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.24/2024
3. Aktivitetet e SKQZ
4. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve në procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut, 21.04.2024 (Grupi III).

5. Raport i Këshillave të KQZ

5.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i emërimit të anëtarëve të KVV, të listës plotësuese

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kodit të sjelljes për anëtarët e KVV
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve të datës 21 prill 2024
4. Shqyrtimi dhe miratimi i mëditjeve për pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV)
5. Shqyrtimi dhe miratimi i aktiviteteve dhe afateve kohore për realizimin e projektit për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj
6. Shqyrtimi dhe miratimi i sloganit, përmbajtjes dhe dizajnit të fletëpalosjes, lapsë kimikëve, byzylykëve, stikersave, maicave dhe fletëvotimit për realizimin e projektit për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj
7. Njoftim lidhur me fushatën e informimit publik, për procesin e votimit, për apo kundër largimit të kryetarëve në komunat: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

5.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i mëditjeve për pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV)

5.3. Këshilli për Marëdhënie me Jashtë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në Programin e Vizitorëve Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve të Parlamentit Evropian 2024 në Tallin 7-10 qershor 2024
2. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në Konferencën “Promovimi i kushteve për fushatën zgjedhore të lira dhe të ndershme në Ballkanin Perëndimor” në Podgoricë, 14-15 Maj 2024
3. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në takimin e rradhës të Grupit Punues Rajonal të Evropës dhe Euroazisë për Media Sociale, Dezinformim dhe Integritet Zgjedhor, në Pragë, 16-17 Maj 2024

6. Të ndryshme!

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi hapi mbledhjen dhe paraqiti agjendën e takimit. Ai tha se mungojnë 4 anëtarë të KQZ, por ka kuorum.

Alban Krasniqi, tha se meqenëse se sot është ditë zie për viktimat e dhunës si pasojë e dhunës që po shfaqet nga burrat (bashkëshortët) ndaj gjinisë së kundërt, propozoj që KQZ të mbajë një minutë heshtje në reflektim shoqërorë dhe si ditë zie ndaj kësaj dukurie të shëmtuar...

Anëtarët e KQZ-së, mbajtën një minutë heshtje.

Arianit Elshani, përpara se të miratohet rendi i ditës, kërkoi që të tërhiqen nga rendi 3 pika: 1, që është e përfshirë në këshillin për Buxhet dhe Financa ("Shqyrtimi dhe miratimi i mëditjeve për pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV)". Po ashtu, edhe pika 5 dhe 67 ngase, nuk kanë kaluar në KOZ. Pra, nuk janë miratuar për rekomandim.

2. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.24/2024**

Sami Kurteshi: Nuk e kemi pranuar procesverbalin ! Dhe unë, nuk kam si ta votoj!

Burim Ahmetaj: Për shkaqe teknike, nuk është arritur të përfundohet procesverbalin...!

Kreshnik Radoniqi: Largohet nga mbledhja...

3. **Aktivitetet e SKQZ**

Burim Ahmetaj: Keni pranuar dy imella, e që janë 2 pika: Organizimi i zgjedhjeve, dhe aktiviteti i dytë, është procesi i trajnimit për këshillat e VV.

KKZ, në katër komunat janë duke u zhvilluar aktivitete të pandalshme, tha z. Ahmetaj dhe se më datën 3 prill, KQZ në mbledhjen 21/2023, e ka miratuar Listën e Qendrave të Votimit. Në përmbushjen e këtyre përgjegjësisve ligjore, tha z. Ahmetaj, KKZ bashkëpunon me institucione publike. Komunitat janë të obliguara që t'i ofrojnë mbështetjen e nevojshme KKZ-ve në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, depo për materiale, transport, objektet publike për nevoja të votimit apo ambiente tjera për organizimin e trajnimeve të komisionerëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për adaptimin e qendrave komunale të numërimit.

Ahmetaj, raportoi mes dy mbledhjeve se në kuadër të përgatitjeve për procesin e votimit, Komisionet Komunale Zgjedhore në secilën komunë së bashku me drejtorët e shkollave të komunave përkatëse kanë

bërë vlerësimin e secilës shkollë e cila, do të përdoret si Qendër të Votimit. Por, duhet theksuar se pas dorëheqjes së anëtarëve të KKZ –ve (përfaqësues të SP Lista Serbe), nga data 06 prill KKZ në secilën komunë, nuk ka qenë e mundur të komunikohet me disa drejtorë të shkollave dhe, kemi pasur qasje refuzuese me pretendimin se shkollat (disa), nuk do të lejohen për tu përdorur si QV në komuna. Lidhur me këtë, Sekretariati u ka drejtuar shkresë kryetarëve të komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok që në bazë të obligimeve ligjore që kanë komunat për KKZ në secilën komunë, që të marrin të gjitha të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që qendrat e votimit në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, të jenë të qasshme, të përgatitura dhe funksionale për këtë proces zgjedhor.

Ahmetaj, e informoi KQZ se kërkesë e njëjtë, i është drejtuar edhe Minsitrisë së Arsimit, dhe kemi pranuar përgjigje. Përgjigja nga MASHTI, bazuar në nenin 7 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe neni 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat në Republikën e Kosovës, “shkollat janë kompetencë e komunave, përkatësisht komunat kanë kompetencë ekskluzive për shkollat në territorin e tyre.”

Sekretariati, me datën 15 prill ka kërkuar takim me kryetarët e komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut dhe me Drejtorin e Arsimit në Komunën e Mitrovicës së Veriut, si dhe me drejtorët e shkollave. Takimet, janë realizuar me datë 16 prill 2024 dhe në Mitrovicën e Veriut, me datën 17 prill 2024. Pas takimit, kryetarët u zotuan se administrata komunale do të vizitojë secilën shkollë e cila është miratuar si Qendër Votimi. Edhe pas vizitave të këtylla, drejtorët kanë refuzuar t’i japin qasje KKZ-së në shkolla të cilat do të përdoren si QV për shkak se në ditën e zgjedhjeve, më 21 prill janë planifikuar aktivitete shkollore, kulturore, sportive etj.

Rezultatet e qasjes në shkolla (QV) pas vizitave nga administrata e komunave:

Në komunën Leposaviqit, janë 18 QV, ku 3 prej tyre janë të qasshme dhe për 15 (QV) drejtorët e shkollave kanë refuzuar ti japin në përdorim për procesin e votimit.

Në komunën Zubin Potokut, janë 12 QV, ku 2 prej tyre janë të qasshme dhe për 10 (QV) drejtorët e shkollave kanë refuzuar ti japin në përdorim për procesin e votimit.

Në komunën Zveçanit, janë 6 QV, ku 2 prej tyre janë të qasshme dhe 4 (QV) drejtorët e shkollave kanë refuzuar ti japin në përdorim për procesin e votimit.

Në komunën Mitrovicës së Veriut janë 7 QV, ku 3 prej tyre janë të qasshme dhe 4 (QV) drejtorët e shkollave kanë refuzuar ti japin në përdorim për procesin e votimit.

Ahmetaj ka thënë se për shkak të afatit shumë të shkurt deri në ditën e votimit, Sekretariati është duke punuar intensivisht për gjetjen e lokacioneve alternative të cilat, do të shërbejnë si QV në ditën e votimit me 21 prill dhe po ashtu është duke bërë përpjekje maksimale për hapjen e të gjitha Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve.

Sekretariati, e ka njoftuar KQZ-në me këto pengesa për ndalimin e përdorimit të objekteve të shkollave si QV dhe për veprimet e drejtorëve të shkollave përkundër obligimeve të tyre ligjore.

Duke pamundesuar qasjen dhe përdorimin e objekteve publike (shkollave) në pronë të komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, do të drejtohet edhe Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe komunave përkatëse të cilët do të njoftohen me pengesat dhe veprimet e drejtorëve të shkollave gjatë organizimit të procesit të votimit që do të organizohet me 21 prill 2024.

Në vazhdim, tha z. Ahmetaj, sipas planit operacional për ditën e votimit, më 15.04.2024, është zhvilluar trajnimi për stafin e angazhuar si trajner për “trajnimin’ e TMZ-ve në terren. Në trajnim, kanë marrë pjesë 6 zyrtare të cilët, me vendim janë caktuar për t’u angazhuar si zyrtar trajnimi për TMZ-te në katër komunat veriore.

Më 16 prill, ka filluar po ashtu edhe procesi i trajnimit për anëtarët e KVV – ve në komunën e Zubin Potokut. Ekipi trajnues, ka qenë në përbërje: Valjeta Ahmetaj, Armir Rexhaj dhe Agim Kastrati. Trajnimi u zhvillua në sallën e qendrës kulturore ‘Stari Kolashin’, ku prej 25 të planifikuar, prezent ishin vetëm 15 anëtar nga Nisma Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. Iniciativa qytetare në Zubin Potok nuk ka marrë pjesë në këtë trajnim, duke deklaruar se për shkak të informatave të pamjaftueshme se ku do të votojnë. Ditëve në vijim, deri te premtën, presim pjesëmarrjen e tyre!

Lokacioni/salla ku u zhvillua trajnimi ishte e përshtatshëm dhe trajnimi u zhvillua sipas agjendës së paraparë. Vlen të theksohet se risi në këtë trajnim, ishte edhe moduli shtese i votimit me kusht i përgatitur nga DTI, ku ndër të tjera, i tërë aplikacioni/hap pas hapi (me kusht) u prezantua nga trajnerët.

Materialet e trajnimit ishin të mjaftueshme në kopjet e duhura për ushtrime praktike. Për më tepër, trajnimi edhe gjatë ditës së sotme, është duke u zhvilluar dhe do të zgjatë deri të premtën më 21.04.2024, ku edhe raportet do të kemi të përditësuara. Detajet e trajnimit, janë në raport...

Sami Kurteshi, lidhur me këtë raport, në fakt lidhur me gjendjen në komunat veriore përpara ditës së zgjedhjeve tha se, ngadalë po del në sipërfaqe kërkesa e rrejshme, shpifjet për ndjekjen, largimin, pastrimin etnik etj. Ne, tha z. Kurteshi, kemi të bëjmë me zyrtarë publik që menaxhojnë shkolla, objekte

publike, dhe janë qytetarët të Republikës së Kosovës, dhe ata janë të detyruar me ligj dhe kodin penal, ti hapin ato objekte. Gjithë kjo zhurmë, është shkaku i humbjes së monopolit të dhunës nga organizatat terroriste.

Sipas nenit KQZ, bashk me komunat, ti ndjek të këtyllët penalisht (sipas nenit 214 të Kodit Penal që është “Pengimi i procesit të votimit”. Kjo është një lojë shumë e rrezikshme, dhe nuk duhet ë heshtet. Veprimet janë shoviniste. Të gjitha organet kompetente, tha z. Kurteshi, madje edhe në bashkëpunim me KQZ-në, po edhe me policinë e Kosovës ato të hapën, dhe tu tregohet të gjithëve se në Kosovë këto agjenda ata nuk mund ti qojnë përpara...

Ata, janë nën mentorimin e Serbisë, madje nga një person që krejt bota fletë se ai i ka vjedhë votat. Unë kërkoj që të njoftohet Prokurori Publik, kryetarët e Komunave të hapin shkollat dhe qytetarëve tu mundësohet votimi.

Arianit Elshani tha se, ne kemi përvojë për organizim të zgjedhjeve dhe se si edhe në të kaluarën, procesi të mbahet në QV afër qytetarëve.

Nesër, ish dashur të dinim saktë se ku do të votohet. Ky, është bllokimi i procesit dhe, të gjithë ata pengojnë procesin të ndiqen penalisht...

Čemailj Kurtiš: unë thamë se më vjen keq që KQZ angazhohet maksimalisht, por duket që ka shumë probleme në terren. Mua më intereson se a kemi kohë, sepse koha e votimit po afrohet. Kemi edhe pak ditë, dhe të angazhohen edhe institucionet e tjera që zgjedhjet të realizohen pa pengesa. Çka mund të bëjmë, është pyetja ime...?

Alban Krasniqi: Këto janë direktiva të qarta për me pengue një proces: Lista Serbe me Vuqiqin. Tash, ë një subjekt politik që sfidon institucionet e Kosovës, këtë proces etj. Ka ardhur koha që edhe ne si KQZ t'i ndërmarim masat tona, bie fjala pezullimi. Qartë po shihe se mbyllja e shkollave, është direktivë e Listës Serbe. Ky veprim, është pjesë e luftës hibride. Por, humbësit më të mëdhenj janë qytetarët serb...

E them publikisht për Listën Serbe se, përpjekja me pengue jetën demokratike, me e mbajt peng komunitetin serbe, mendoj që do të dështoj! Por, ky subjekt duhet të vihet në vëmendje të arganëve të caktuara...

Burim Ahmetaj, tha se koha është e shkurtë, mirëpo pavarësisht kësaj Sekretariati, po punon intensivisht për lokalizimin e QV-ve. Do të ju njoftojmë shumë shpejt...

Fazli Stollaj: Ky proces ka filluar me iniciativën e 20 % të qytetarëve të atyre komunave, siç është e përcaktuar edhe me ligj. Kështu që çdo përpjekje për me ndal këtë proces, mendoj që është edhe kundëe vullnetit të atyre qytetarëve të nënshkruar. Ne si KQZ nuk duhet të ndalemi...

4. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve në procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, 21.04.2024 (Grupi III).

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës tha se aplikimi për akreditim për vëzhgim ka përfunduar më 15 prill. Nga 13 – 15 prill kanë aplikuar 29 organizata, që në total janë 271 vëzhgues.

Kryetari Radoniqi, paraqiti emrin dhe numrin e vëzhguesve.

Në këtë pikë diskutuan: Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Besnik Buzhala, Sami Kurteshi. Ndërsa, u propozua që afati për media të zgjatet deri më 18 prill.

Në fund, anëtarët e KQZ-së me shtatë vota për, akredituan 29 organizata, e po ashtu u miratua edhe zgjatja e afatit deri në ora 18.

Gjithashtu, u akredituan edhe 4 vëzhgues që kanë aplikuar pas afatit.

Kreshnik Radoniqi: E kemi edhe një rekomandim për ndryshim – vendimi për RTK-në, pra të shfuqizohet vendimi i ma hershëm i akreditimit të RTK 2 me 19 vëzhgues, dhe të akreditohet RTK me 31 vëzhgues.

Me shtatë vota, u miratua edhe ky rekomandim.

5. Raporti i Këshillave të KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i emërimit të anëtarëve të KVV, të listës plotësuese

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar listën plotësuese për emërimin e anëtarëve të KVV-e. Ndryshimet që i kemi bërë, jemi siguruar që secili VV të ketë minimumin e komisionarëve prej tre anëtarëve.

Komuna e Leposaviqit, do ketë 108 anëtarë të KVV, duke përfshirë edhe anëtarët rezervë. Komuna e Zubin Potokut ka 75 nominime të anëtarëve të KVV. Në komunën e Zveqanit janë 49 komisionerë. Komuna e Mitrovicës së Veriut janë 103 anëtarë të KVV-e.

Me 6 vota për dhe 1 abstenim (Gotdana Llaban), u miratuan anëtarët e KVV-e.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së me 7 vota për miratuan Kodin e sjelljes për anëtarët e KVV.

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar edhe Planin Operacional për ditën e zgjedhjeve të datës 21 prill 2024. Sipas planit, janë katër ekipe në katër komuna nga Sekretariati, pastaj parashihen linjat e komunikimit, kontaktet, konferencat për shtyp, raportimi i daljes së votuesve në votim, ashtu si edhe rezultatet preliminare.

Anëtarët e KQZ-së me 7 vota për, miratuan Planin Operacional.

Shqyrtimi dhe miratimi i aktiviteteve dhe afateve kohore për realizimin e projektit për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj

Arianit Elshani tha se, bëhet fjalë për këtë aktivitet që do të zhvillohet nga data 29 prill, deri më 31 maj. Ai, e njoftoi KQZ-në lidhur me aktivitetet dhe produktet që janë të destinuara për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj.

(Nuk ka incizim)

6. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i mëditjeve për pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV).

Gordana Llaban, e njoftoi KQZ-në lidhur me pagesat e stafit të angazhuar. Me 7 vota për anëtarët e KQZ-së, miratuan mëditjet për pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit.

7. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në Programin e Vizitorëve Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve të Parlamentit Evropian 2024 në Talin 7-10 qershor 2024:

Kreshnik Radoniqi, tha se e kemi një ftesë për me marrë pjesë në Programin e Vizitorëve Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve të Parlamentit Evropian 2024 në Estoni më 7-10 qershor 2024. Ftesa është vetëm për 2 persona. E kemi ftesën edhe për pjesëmarrje në konferencën “Promovimi i kushteve për fushata zgjedhore të lira dhe të ndershme në Ballkanin Perëndimor” që mbahet në Podgoricë prej 14-15 maj. Edhe kjo, është vetëm për dy persona.

Shpenzimet për Estoni, u takojnë pjesëmarrësve. Në Podgoricë të gjitha shpenzimet janë të përfshira, transporti, fjetja, ushqimi.

E kemi edhe ftesën nga IFES për takimin e radhës të Grupit Punues Rajonal të Evropës dhe Euroazisë për Media Sociale, Dezinformim dhe Integritet Zgjedhor që mbahet në Pragë, prej 16-17 maj. Ftesa është për dy persona. Në Këshill, jemi dakorduar që në këto tri evente të marrim pjesë.

Në Estoni, mendojmë të udhëtojnë Sami Kurteshi dhe Premtim Rrustemi.

Në Podgoricë, është propozimi të udhëtojmë unë dhe Besnik Buzhala.

Në Ceki, kishte propozim që të udhëtojnë Alban Krasniqin dhe Arianit Elshani.

Me 7 vota për, miratohen që të tri udhëtimet, me kandidatët e propozuar.

8.Të ndryshme !

Burim Ahmetaj, pyeti anëtarët e KQZ-së rreth raportit vjetor të punës, e i cili raport deri më 30 prill me u dërguar në Kuvend.